

Akademia e Shkencave e Shqipërisë zhvilloi në datat 10–12 tetor 2018 veprimtarinë shkencore “3-rd International Workshop on recent LHC Physics results and related topics” në bashkëpunim me Fakultetin e Shkencave të Natyrës të Universitetit të Tiranës; CERN-in; institutet e fizikës bërthamore të Francës dhe të Italisë; me Universitetin Politeknik të Barit dhe me mbështetjen e ambasadave të Italisë, Francës dhe Zvicrës, si dhe të Institutit të Kulturës Italiane në Tiranë.

Nisma e kësaj veprimtarie të përbashkët shkencore të fizikanëve shqiptarë me CERN-in, (Qendra Europiane për Kërkime Bërthamore), i takon Ludwik Dorbrzynski-t dhe Daniel Denegri-t, profesorë të shkollave të mëdha të Parisit dhe njëkohësisht kontribuues të rëndësishëm në eksperimentet e CERN-it. Me anë të përfaqësuesve të tyre ata morrën kontakt me fizikanin shqiptar, Artan Boriçi, në atë kohë në CERN. Kështu, më 8 tetor 2012 në sallën e Rektoratit të Universitetit të Tiranës u zhvillua një takim ku u planifikua që në 2014-n, në Universitetin e Shkodrës, të zhvillohet Workshop-i i parë, që në përfundim të tij arriti edhe në nënshkrimin e marrëveshjes së parë ndërmjet qeverisë shqiptare me CERN-in.

Në vitin 2016, më 26–27 shtator u zhvillua takimi i dytë, sukcesi i të cilit ishte si arsimit, ashtu edhe shkencor. Duke parë interesin në rritje të komunitetit shkencor e më gjerë në Shqipëri, si dhe pjesëmarrjen e specialistëve të njohur nga bota, u vendos që takimi i tretë të mbahej në një kohëzgjatje prej tri ditësh. Komisioni Shkencor dhe Organizativ me kryetar prof. Ludwik Dobrzynski-n propozoi që takimi i tretë të zhvillohej në bashkëpunim me Akademinë e Shkencave të Shqipërisë. Profesorët, Salvator Bushati, Vasil Tole dhe Floran Vila, anëtarë të Akademisë e mirëpritën këtë ide duke thelluar edhe bashkëpunimin e ngushtë të departamentit të Fizikës të Fakultetit të Shkencave të Natyrës (UT) me Akademinë e Shkencave e Shqipërisë.

Workshop-i III, i mbajtur nga 10–12 tetori, u përshëndet nga zëvendësministrja e Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Dr. Besa Shahini, akad. Salvatore Bushati nga Akademia dhe prof. Spiro Drushku nga Fakulteti i Shkencave të Natyrës. Po kështu përshëndetën shkëlqesitë e tyre: ambasadori i Republikës së Italisë në Shqipëri, zoti Alberto Cutillo, ambasadorja e Republikës së Francës në Shqipëri, zonja Christina Vasak si dhe përfaqësuesja e Ambasadës së Konfederatës Zvicerane në Shqipëri, zonja Debora Kern, si dhe përfaqësuesi i CERN, prof. Christoph Schäfer.

Profesor Bushati theksoi kontributin e diplomatëve të huaj në mbështetjen e dhënë për këtë veprimtari shkencore që nga zanafilla e saj, ku komuniteti shkencor dhe mbarë dashamirësit e fizikës e më gjerë të kërkimit shkencor, në Shqipëri ndienë konkretisht kontributin e Diplomacisë për Shkencën.

Zëvendësministrja Dr. Shahini theksoi rëndësinë e kërkimit shkencor, ku një rol kryesor luan bashkëpunimi me institucionet prestigjioze në fushën e shkencës në transferimin e dijeve e teknologjive, e cila është një ndihmesë në plotësimin e standardeve nderkombëtare të prezantuara në dokumentin e kapitullit të 25 “acquis communautaire” dhe reformat që Qeveria ka ndërmarrë në këtë drejtim për fuqizimin e saj. Dr. Shahini , gjithashtu tregoi vullnetin që ka institucioni i saj, por dhe ajo presonalisht për mbështetjen e zhvillimit sa më frytë frytëdhënës të institucioneve shkencore shqipëtare me CERN, the European Organisation for Nuclear Research.

Prof. Drushku theksoi bashkëpunimin e shkëlqyer të Fakultetit të Shkencave të Natyrës me Akademinë e Shkencave, si garanci e zhvillimit të marrëdhënieve të mëtejshme dhe në objektivat që do të përcaktohen me CERN.

Shkëlqesitë e tyre, Ambasadorët e Italisë dhe Francës, Z. Cutillo dhe Znj. Vasak, si dhe përfaqësuesja e Ambasadës së Konfederatës Zvicerane në Shqipëri, zonja Kern, theksuan rëndësinë e bashkëpunimit me CERN edhe në Shqipëri në zhvillimin e shkencës bazë e të aplikuar dhe ndikimin në fusha të ndryshme të shkencave dhe jetës: mjekësisë, nanoteknologjisë, etj. Ata u shprehën se do të jenë të gatshëm të mbështesin këtë nismë e me prirje kërkuesit e rinj. Gjithashtu, ata duke folur në emër të qeverive të tyre respektive, anëtare të Bashkimit Europian, shprehën angazhimin e këtij instiucioni në mbështetje të kërkuesve shqiptarë për projektet e financuara nga Bashkimi Europian si TAIEX, HORIZON 2020, IPA, etj.

Ambasadori Cutillo, gjithashtu organizoi me këtë rast një pritje në Ambasadën Italiane ku morën pjesë ambasadorë, Akademikë, profesorë e studentë të ekselencës brenda e jashtë vendit, stazhierë pranë CERN-it, etj.

Profesor Christoph Schäfer, Këshilltar për marrëdhëniet me vendet jo-anëtare të CERN, vlerësoi organizimin cilësor të këtij workshopi dhe rëndësinë e këtij bashkëpunimi. Ai theksoi se CERN do ta mbështesë Shqipërinë dhe se e sheh këtë bashkëpunim si strategjik për Shqipërinë e më gjerë, i cili do të ketë ndikim mbi zhvillimet e domosdoshmërive të vendit. Gjithashtu në ditën e dytë të workshopit Prof. Christoph Schäfer pasi bëri një ekspozë të punës që zhvillohet në CERN, vuri theksin në rëndësinë e transferimit të teknologjive, të cilat ideohen dhe zhvillohen në CERN. Në përgjigje të pyetjeve nga auditori për bashkëpunimin, ai theksoi se iniciativat duhet të vinë nga pala shqipëtare.

Risia shkencore e këtij takimi ishin prurjet e reja të studiuesve nga fizika e grimcave dhe astrofizika. Mund të përmendim Nicola de Filippis-in dhe Francesco Laparco-n nga Bari, tashmë bashkëpunues të rregullt me Tiranën. Nga teoricienët mund të përmendim Philippe de Forcrand-

in nga ETH Zurich-Zvicër dhe CERN, Leonardo Giusti-n nga Milano, Itali, dhe Christof Gattringer-in nga Graz, Austri. Eva Barabara Holzer nga CERN ishte gjithashtu kontribuese e re në workshop. Ky takim mbledhi edhe diasporën shqiptare të fizikës fundamentale, ku referuan edhe studentë të ekselencës shqiptare, Bianka Meçaj nga Mainz.

Në aspektin edukativ, paralel me takimin u shfaq ekspozita e CERN-it, që u vizitua prej prurjesh të shumta nga nxënës të shkollave të mesme.

Takimi i 3-të shënoi pjesëmarrjen aktive në referime të studentëve të të gjitha niveleve akademike e disiplinave të Fakultetit të Shkencave të Natyrës.

Aktiviteti u mbyll më 12 tetor. Për suksesin e mëtjshëm shkencor dhe edukativ të këtij aktiviteti akad. Bushati hodhi idenë e shtimit e një ditë të katërt, si dhe zgjerimin tematik për të përfshirë sa më shumë të interesuar, në përgjigje të politikave shumëdisiplinore të CERN-it dhe të Akademisë së Shkencave.

Në përfundim u organizua një tryezë e rrumbullakët ku u diskutuan arritjet e workshopit si dhe u diskutua për prioritet në të ardhmen të cilat u përmbledhën në një dokument, Kartën e Workshopit.

Kjo Kartë merr parasysh ndryshimet në tendencat shkencore, politike, kulturore dhe sociale në Shqipëri si dhe përpjekjet e qeverisë shqiptare dhe të gjitha palëve të interesit për të plotësuar kërkesat për anëtarësim të Shqipërisë në Bashkimin Europian, veçanërisht Kapitullin 25 “Shkencë dhe Kërkim” dhe Kapitullin 26 “Edukimi dhe Kultura”. Gjithashtu ajo njeh nevojën për t’ju përgjigjur trendeve në shkencë dhe teknologjive të reja dhe ndikimit të tyre në mënyrën tonë të të jetuarit dhe mjedis. Akademia e Shkencave e Shqipërisë do bëjë çdo përpjekje që vendi të bëhet destinacion tërheqës për kërkuesit shkencorë dhe bashkëpunorët shkencor anembanë botës.

Në përgjigje të bashkëpunimit dhe politikave shumëdisiplinore të CERN DHE Seksionit të Shkencave Natyrore dhe Teknike të Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, disa qëllime afat-shkurtra dhe afat-mesme për të ardhmen dolën gjatë takimit si të paraqitura në Kartën e më poshtme:

- Sensibilizimi i komunitetit shkencor, kërkuesve pasuniversitar dhe nivelit mastër e më tej me njohjen e veprimtarisë kërkimore-shkencore të CERN-it, të dhëna mbi metodologjitë e bashkëpunimit të saj me komunitetin shkencor në botë etj si dhe prioritetet e saj, funksionimin dhe arritjet në kohën e sotme

- Identifikimi, vlerësimi i burimeve njerëzore e shkencore në institucionet e kërkimit shkencor dhe strukturave të tjera të kërkimit shkencor në Shqipëri për kapacitetet aktuale për kërkim bazë e aplikativ dhe zhvillim
- Krijimi i një baze të dhënash (e përditësueshme) për kontigjente pedagogësh dhe mësuesish me kapacitet në fushën e fizikës inxhinierike, matematikës inxhinierike, fizikës mjeksore, teknologjive të informacionit, inxhinierive dhe fushave të specialitetit të ngushtë që lidhet me to
- Organizimi i trajnimeve/informative online për grupe interesi të problematikave të veçanta <https://home.cern/about/what-we-do/our-educational-programmes>
- Organizime të veprimtarive shkencore ndërkombëtare (konferenca, seminare workshope, konsulta) për problematikat aktuale të kërkimit në CERN dhe nevolat/thirrjet për bashkepunimi nga ana e saj
- Krijimi i një hapsirë informative për bashkëpunimin ASHSH me CERN në webin zyrtar të Akademisë
- Komunikimet e herëpashershme me politikë-bërjen (të diploacisë për kontributin shkencë dhe V.S) dhe vendim-marrjen e strukturat e ngarkuara për kërkimin shkencor, teknologjik dhe inovacionin në Shqipëri
- Raportime vjetore mbi veprimtaritë e bashkëpunimit midis Shqipërisë dhe CERN
- Së fundmi arritjet në drejtim të standardeve të domosdoshme për anëtarësim në organizatën CERN